

RAPORT

Tryeza e Rrumbullakët

Universiteti si platformë për dialog ndërkulturor dhe bashkëjetesë në Kosovë

 Data: 20 maj 2026

 Vendi: Hotel Dukagjini, Pejë



Organizator: Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut

Institucioni: Universiteti "Haxhi Zeka"



Universitetet moderne përfaqësojnë institucione me ndikim të shumëfishtë në zhvillimin e shoqërisë. Përveç funksionit të tyre tradicional në arsim, kërkim shkencor dhe inovacion, ato kanë marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në promovimin e vlerave demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, ndërtimin e dialogut ndërkulturor dhe forcimin e kohezionit social. Në shoqëritë multietnike dhe pluraliste, universitetet janë hapësira ku bashkëjetojnë identitete, kultura dhe tradita të ndryshme, duke krijuar mundësi reale për zhvillimin e komunikimit, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve.

Në Republikën e Kosovës, ku bashkëjetesa ndërmjet komuniteteve përbën një nga shtyllat kryesore të stabilitetit demokratik dhe zhvillimit institucional, arsimi i lartë ka një përgjegjësi të veçantë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, mobilitetit akademik dhe bashkëpunimit me institucionet publike dhe organizatat vendore e ndërkombëtare, universitetet ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kulturës së dialogut, respektimit të diversitetit kulturor dhe reduktimit të paragjykimëve.

Pikërisht mbi këtë filozofi u mbështet organizimi i Tryezës së Rrumbullakët "Universiteti si platformë për dialog ndërkulturor dhe bashkëjetesë në Kosovë", e organizuar nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut e Universitetit "Haxhi Zeka", me rastin e shënimit të 21 Majit – Ditës Botërore për Diversitetin Kulturor për Dialog dhe Zhvillim. Aktiviteti u organizua më 20 maj 2026 në Hotelin "Dukagjini" në Pejë dhe mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, komunitetit akademik, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe komuniteteve jo-shumicë.

Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze nuk ishte vetëm shënimi i një date me rëndësi ndërkombëtare, por krijimi i një platforme akademike dhe institucionale për diskutimin e sfidave dhe mundësive që lidhen me promovimin e dialogut ndërkomunitar në arsimin e lartë. Aktiviteti synoi të nxistë një debat të argumentuar mbi politikat universitare për diversitetin dhe përfshirjen, rolin e programeve studimore në gjuhët e komuniteteve, sfidat që lidhen me diskriminimin dhe pengesat sociale, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Një komponent i rëndësishëm i aktivitetit ishte prezantimi i rezultateve të hulumtimit të realizuar nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut me temën "Universiteti si Platformë për Dialog Ndërkulturor dhe Bashkëjetesë në Kosovë", i cili u zhvillua me pjesëmarrjen e respondentëve nga komunitete të ndryshme dhe në dy gjuhë – shqip dhe boshnjakisht. Hulumtimi evidentoi perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me rolin e universiteteve në promovimin e diversitetit kulturor, dialogut ndërkomunitar dhe ndërtimin e paqes sociale, duke shërbyer si bazë shkencore për diskutimet e zhvilluara gjatë tryezës.

Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut • Universiteti "Haxhi Zeka"



2 Qëllimi & Objektivat

I Qëllimi Kryesor

Tryeza e mumbullakët kishte për qëllim krijimin e një platforme të përbashkët ndërmjet komunitetit akademik, institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile për të diskutuar rolin e universiteteve në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe bashkëjetesës në Kosovë.

I Objektivat Kryesore

- ✓ Prezantimi i rezultateve të hulumtimit të realizuar nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut
- ✓ Diskutimi mbi politikat institucionale për promovimin e diversitetit dhe përfshirjes në universitetet publike
- ✓ Analizimi i rolit të programeve studimore në gjuhët e komuniteteve si instrument për integrim dhe pjesëmarrje të barabartë
- ✓ Identifikimi i pengesave sociale, ekonomike, gjuhësore dhe institucionale me të cilat përballen komunitetet
- ✓ Promovimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkomunitar
- ✓ Formulimi i rekomandimeve konkrete për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet publike në funksion të promovimit të dialogut ndërkulturor dhe ndërtimit të paqes sociale



Aktivitet akademik me rëndësi ndërkombëtare

3 Organizimi i Aktivitetit

| Vendi dhe Koha

Tryeza e rrumbullakët u organizua nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut në Universitetin "Haxhi Zeka", si pjesë e aktiviteteve institucionale kushtuar promovimit të të drejtave të njeriut, dialogut ndërkomunitar dhe bashkëpunimit ndërkulturor.

Aktiviteti u zhvillua në ambientet e Hotelit "Dukagjini" në Pejë dhe filloi në orën 09:30 me pritjen dhe regjistrimin e pjesëmarrësve. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të universiteteve publike, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të OSBE-së, Institucionit të Avokatit të Popullit, sistemit gjyqësor dhe prokurorial, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve komunale, si dhe përfaqësues të komuniteteve boshnjake, serbe, rome, ashkalinj dhe egjiptiane.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve nga fusha të ndryshme krijoi një diskutim ndërdisiplinor, duke mundësuar trajtimin e temës nga perspektiva akademike, juridike, institucionale dhe sociale. Kjo përbërje e panelit pasqyroi vetë karakterin ndërsektorial të çështjes së dialogut ndërkulturor dhe promovimit të diversitetit kulturor në Kosovë.



Bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndërkomunitar

4 Hapja Zyrtare e Tryezës

Pas regjistrimit të pjesëmarrësve, në orën 10:00 filloi ceremonia zyrtare e hapjes së tryezës.

Aktivitetin e hapi Prof. Dr. Armand Krasniqi, Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka", i cili në fjalën e tij përshëndetëse u uroi mirëseardhje të gjithë panelistëve, përfaqësuesve institucionalë, partnerëve ndërkombëtarë, profesorëve, studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë.

Në adresimin e tij, Rektori theksoi se universitetet moderne duhet të shihen si institucione të përgjegjësisë publike, të cilat përveç misionit arsimor dhe kërkimor kanë edhe detyrimin të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie demokratike, të bazuar në respektimin e diversitetit kulturor, dialogut ndërkomunitar dhe të drejtave të njeriut. Ai nënvizoi se Universiteti "Haxhi Zeka" ka integruar këto parime në strategjinë e tij zhvillimore dhe mbetet i përkushtuar në krijimin e një mjedisi akademik gjithëpërfshirës, ku studentët e të gjitha komuniteteve trajtohen në mënyrë të barabartë dhe kanë mundësi të zhvillohen profesionalisht dhe qytetarisht.

Rektori vlerësoi gjithashtu punën e Qendrës për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut në organizimin e aktiviteteve që nxisin dialogun ndërkulturor dhe theksoi se rezultatet e hulumtimit të prezantuar gjatë kësaj tryeze përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e politikave universitare dhe bashkëpunimit me institucionet publike në të ardhmen.

Prezantimi i hulumtimit

Në kuadër të tryezës së rrumbullakët u prezantua hulumtimi me titull "Roli i universiteteve në promovimin e diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkomunitar në Kosovë", i realizuar nga MSc. Edlira Juniku. Hulumtimi trajtoi rolin e institucioneve të arsimit të lartë në ndërtimin e dialogut ndërkulturor, promovimin e tolerancës dhe forcimin e bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Përmes të dhënave të mbledhura dhe analizës së perceptimeve të respondentëve, u theksua se universitetet kanë potencial të rëndësishëm për të ndikuar në reduktimin e paragjytimeve, krijimin e hapësirave gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e një kulture akademike të bazuar në respekt, barazi dhe bashkëpunim ndërkomunitar.



Roli i universiteteve në ndërtimin e shoqërisë demokratike

Dr. Neshad Albani

Mysafir Nderi • Aktivist i të Drejtave të Njeriut

Dr. Neshad Albani është mjek, humanist, aktivist i të drejtave të njeriut dhe një nga figurat më të njohura të shoqërisë civile në Kosovë. Për dekada me radhë ai ka qenë i angazhuar në promovimin e paqes, dialogut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar përmes organizatës Rotary International, ku ka luajtur rol kyç në pranimin e Kosovës në këtë organizatë dhe në realizimin e dhjetëra projekteve humanitare në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe zhvillimit të komunitetit. Dr. Albani është gjithashtu i njohur për angazhimin e tij në mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të shqiptarëve në platformat digjitale globale, si dhe për bashkëpunimin me Kosovo Center for Human Rights dhe Carnegie Council for Ethics in International Affairs, duke kontribuar në promovimin e etikës publike, të drejtave të njeriut dhe dialogut ndërkulturor. Përmes veprimtarisë së tij ai ka ndërtuar ura bashkëpunimi ndërmjet institucioneve vendore dhe organizatave ndërkombëtare, duke promovuar vlerat universale të solidaritetit, tolerancës dhe bashkëjetesës.

Kontributi në Tryezën e Rrumbullakët

Si mysafir nderi i aktivitetit, Dr. Neshad Albani përshëndeti organizimin e kësaj tryeze, duke vlerësuar rëndësinë e nismave akademike që vendosin në qendër dialogun ndërkulturor dhe respektimin e diversitetit. Në fjalën e tij ai theksoi se universitetet përfaqësojnë institucionet më të rëndësishme në formimin e brezave të rinj dhe në kultivimin e kulturës së paqes. Sipas tij, dialogu ndërmjet komuniteteve nuk ndërtohet vetëm përmes politikave shtetërore, por mbi të gjitha përmes edukimit, bashkëpunimit dhe respektimit të ndërsjellë, procese në të cilat universitetet kanë përgjegjësi të pazëvendësueshme.

Dr. Albani nënvizoi se zhvillimi i një shoqërie demokratike kërkon institucione të forta akademike, të cilat promovojnë mendimin kritik, etikën publike dhe përgjegjësinë qytetare. Ai vlerësoi se promovimi i diversitetit kulturor nuk duhet të shihet si obligim formal institucional, por si një vlerë që pasuron jetën akademike dhe kontribuon në zhvillimin afatgjatë të shoqërisë. Në përfundim të fjalës së tij, ai inkurajoi universitetet që të vazhdojnë të ndërtojnë partneritete me organizatat ndërkombëtare, institucionet publike dhe komunitetet lokale, duke krijuar projekte të përbashkëta që kontribuojnë në forcimin e dialogut, respektimit të të drejtave të njeriut dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve.



Promovim i paqes, dialogut dhe të drejtave të njeriut

Prof. Dr. Armand Krasniqi

Rektor • Universiteti "Haxhi Zeka"

Prof. Dr. Armand Krasniqi është Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka" dhe profesor i rregullt në fushën e së drejtës biznesore. Ai është një ndër figurat më të rëndësishme në zhvillimin institucional të Universitetit "Haxhi Zeka", duke qenë pjesë e proceseve të themelimit të universitetit, fillimisht si Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Biznesit dhe më pas si Kryetar i Këshillit të Përkohshëm Drejtues. Gjatë mandatit të tij si rektor është angazhuar në avancimin e cilësisë akademike, ndërkombëtarizimin, zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe modernizimin e programeve studimore, duke e orientuar universitetin drejt standardeve evropiane të arsimit të lartë.

Prezantimi i Rektorit

Në kuadër të pjesës së parë të tryezës, Prof. Dr. Armand Krasniqi prezantoi qasjen institucionale të Universitetit "Haxhi Zeka" ndaj promovimit të diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkombëtar. Ai theksoi se universiteti, si institucion publik i arsimit të lartë, ka përgjegjësi jo vetëm për zhvillimin akademik të studentëve, por edhe për formimin e tyre si qytetarë aktivë, të përgjegjshëm dhe të aftë për të jetuar e bashkëpunuar në një shoqëri multietnike.

Në vijim, Prof. Dr. Krasniqi prezantoi rezultatet e hulumtimit të realizuar nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut, me titull "Universiteti si Platformë për Dialog Ndërkulturor dhe Bashkëjetesë në Kosovë". Prezantimi u mbështet në të dhënat empirike të mbledhura nga respondentë të komuniteteve të ndryshme, duke analizuar perceptimet mbi rolin e universiteteve në promovimin e diversitetit kulturor, përfshirjes dhe reduktimin e paragjyqimeve.

Rezultatet e hulumtimit treguan se pjesëmarrësit e konsiderojnë universitetin si një institucion me potencial të lartë për ndërtimin e dialogut ndërkombëtar dhe promovimin e kulturës së bashkëjetesës. Megjithatë, u identifikua edhe nevoja për zgjerimin e politikave institucionale që mbështesin përfshirjen e komuniteteve, zhvillimin e programeve shumëgjuhëshe, organizimin e aktiviteteve ndërkulturore dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në projekte të përbashkëta.

Në analizën e tij, Prof. Dr. Krasniqi theksoi se universitetet duhet të kalojnë nga roli tradicional i institucioneve arsimore drejt rolit të aktorëve aktivë në zhvillimin shoqëror, duke kontribuar në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve, promovimin e tolerancës dhe forcimin e kohezionit social. Ai vlerësoi se gjetjet e hulumtimit përbëjnë një bazë të rëndësishme për hartimin e politikave të ardhshme universitare dhe për zhvillimin e projekteve të reja në bashkëpunim me partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë.



Politika institucionale për diversitet dhe përfshirje

Prof. Asoc. Dr. Anita Cucović

Profesore • Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Haxhi Zeka"

Prof. Asoc. Dr. Anita Cucović është profesoreshë në Fakultetin e Biznesit të Universitetit "Haxhi Zeka" dhe një nga bartëset kryesore të mësimdhënies në programet studimore në gjuhën boshnjake. Përveç angazhimit të saj në procesin mësimor dhe kërkimor, ajo ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e programeve akademike për komunitetin boshnjak, në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve brenda universitetit. Si koordinatore e kësaj tryeze të rrumbullakët, ajo kontribuoi në organizimin dhe realizimin e aktivitetit, duke siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe të komuniteteve në një diskutim të përbashkët mbi dialogun ndërkulturor.

Tema e Prezantimit

Në cilësinë e përfaqësueses së Fakultetit të Biznesit, Prof. Asoc. Dr. Anita Cucović trajtoi temën "Gjuha dhe qasja në arsim – Roli i programeve të studimit në gjuhët e komunitetit", duke e ndërlidhur këtë çështje me rezultatet e hulumtimit të prezantuar në fillim të aktivitetit.

Në prezantimin e saj ajo theksoi se gjuha është një nga elementet themelore të identitetit kulturor dhe një faktor kyç për garantimin e qasjes së barabartë në arsimin e lartë. Duke u mbështetur në përvojën e Fakultetit të Biznesit, ajo prezantoi zhvillimin historik të programeve studimore në gjuhën boshnjake në Universitetin "Haxhi Zeka", duke theksuar se këto programe kanë luajtur rol të rëndësishëm në integrimin akademik të komunitetit boshnjak dhe në krijimin e mundësive të barabarta për arsimim universitar.

Ajo rikujtoi se mësimdhënia në gjuhën boshnjake ka kaluar një proces të gjatë institucionalizimi, duke filluar nga grupet e para të organizuara me mbështetjen e profesorëve vizitorë, deri te akreditimi i plotë i programeve Bachelor dhe Master në Fakultetin e Biznesit. Sipas saj, ky zhvillim nuk ka kontribuar vetëm në avancimin e arsimit të komunitetit boshnjak, por edhe në forcimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe në afirmimin e Universitetit "Haxhi Zeka" si institucion që promovon diversitetin kulturor dhe përfshirjen.



Programet shumëgjuhëshe si instrument për integrimin

Sfida e integrimit kundrejt segregacionit- Prof. asoc. Anita Cucović

Roli i gjuhës amtare në arsimin e lartë në Kosovë përballët me sfidën e balancimit ndërmjet ruajtjes së identitetit dhe integrimit të komuniteteve. Në Kosovë funksionojnë paralelisht dy sisteme arsimore: sistemi në gjuhën shqipe, ku përfshihen edhe programe në gjuhën boshnjake dhe turke, si dhe sistemi në gjuhën serbe, i cili vepron në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë. Këto sisteme u mundësojnë komuniteteve të studiojnë në gjuhën e tyre amtare, por në të njëjtën kohë kufizojnë bashkëpunimin dhe kontaktin ndërmjet studentëve të komuniteteve të ndryshme, duke e bërë më të vështirë dialogun dhe integrimin shoqëror.

Perspektiva ekonomike dhe tregu i punës

Arsimi universitar në gjuhën amtare ndihmon në përvetësimin më të lehtë të njohurive, por mungesa e njohjes së gjuhëve të tjera zyrtare kufizon mundësitë e punësimit. Studentët që diplomohen vetëm në gjuhën serbe ose boshnjake, pa njohuri të shqipes, dhe anasjelltas, kanë më pak mundësi lëvizjeje në tregun e punës brenda Kosovës. Si pasojë, shumë të diplomuar kërkojnë punë vetëm në komunitetet e tyre, në sektorin publik ose jashtë vendit, duke kontribuar në fenomenin e ikjes së trurit.

Statusi i mësimdhënies në gjuhën boshnjake

Mësimdhënia në gjuhën boshnjake ka kaluar një zhvillim të rëndësishëm. Para vitit 2001 nuk kishte programe universitare në këtë gjuhë. Gjatë periudhës 2001–2011 u hapën grupet e para paralele me ndihmën e profesorëve vizitorë, ndërsa pas themelimit të Universitetit "Haxhi Zeka" në vitin 2011 programet në gjuhën boshnjake fituan status të plotë ligjor dhe u akredituan rregullisht në nivelin Bachelor dhe Master. Kjo krijoi mundësi që studentët boshnjakë të përfundonin të gjithë ciklin e studimeve në gjuhën e tyre.

Problemi me kuadrin akademik

Një nga sfidat kryesore ishte mungesa e profesorëve vendas me doktoraturë që flisnin gjuhën boshnjake. Fillimisht ky problem u zgjidh duke angazhuar profesorë vizitorë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Sanxhaku, si dhe profesorë vendas shqiptarë që njihnin gjuhën boshnjake ose serbokroatishten. Me kalimin e kohës, të diplomuarit e gjeneratave të para vazhduan studimet pasuniversitare dhe u bënë pjesë e stafit akademik, duke zvogëluar varësinë nga profesorët e jashtëm.

Institucionalizimi dhe akreditimi

Me themelimin e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, programet në gjuhën boshnjake iu nënshtruan të njëjtave standarde si programet në gjuhën shqipe. Akreditimi i programeve Bachelor dhe më pas hapja e studimeve Master forcuuan pozitën e tyre dhe garantuan cilësi të barabartë në arsimin e lartë.

Futja e studimeve Master

Hapja e studimeve Master në gjuhën boshnjake ishte një hap i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit të lartë të këtij komuniteti. Studentët fituan mundësinë të përfundonin të gjithë ciklin universitar (3+2) në qytetin e tyre, ndërsa fakulteti filloi të krijojë kuadrin e vet akademik nga komuniteti boshnjak, duke siguruar zhvillim dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Përfundim

Programet universitare në gjuhën amtare janë një garanci për ruajtjen e identitetit dhe të drejtave të komuniteteve në Kosovë. Megjithatë, për të ndërtuar një shoqëri më të integruar dhe një treg pune më gjithëpërfshirës, është e rëndësishme që krahas arsimit cilësor në gjuhën amtare të inkurajohet edhe mësimi i gjuhëve të tjera zyrtare, bashkëpunimi ndëruniversitar dhe programet e shkëmbimit. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e ndarjeve ndërmjet komuniteteve dhe në krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë studentët në Kosovë.

Z. Suad Sadiković

Përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Z. Suad Sadiković është përfaqësues i Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, i angazhuar në Qendrën Rajonale, me përvojë të gjatë në promovimin e të drejtave të komuniteteve, dialogut ndëretnik, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të proceseve demokratike.

Në fjalën e tij, z. Suad Sadiković vlerësoi iniciativën e Universitetit "Haxhi Zeka" dhe të Qendrës për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut për organizimin e një aktiviteti që adreson një nga temat më të rëndësishme të zhvillimit demokratik në Kosovë. Ai theksoi se universitetet janë partnerë strategjikë të OSBE-së në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe në ndërtimin e kapaciteteve demokratike të brezit të ri.

Ai vuri në dukje se përvoja ndërkombëtare dëshmon se institucionet e arsimit të lartë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ndërtimin e kulturës së tolerancës, respektimit të diversitetit dhe reduktimit të paragjyimeve. Për këtë arsye, sipas tij, universitetet duhet të krijojnë më shumë hapësira për dialog, projekte të përbashkëta studentore dhe bashkëpunim ndërkombëtar që mundësojnë njohjen reciproke ndërmjet komuniteteve.

Ai theksoi gjithashtu se OSBE-ja do të vazhdojë të mbështesë iniciativat akademike që kontribuojnë në promovimin e të drejtave të njeriut, pjesëmarrjes së komuniteteve dhe zhvillimit të politikave publike gjithëpërfshirëse, duke e konsideruar arsimin si një nga mekanizmat më efektivë për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë.



Bashkëpunim strategjik për dialog ndërkulturor

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi

Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës • Profesor Universitar

Prof. Dr. Fahrush Rexhepi është profesor universitar, doktor i shkencave historike dhe teologjike, si dhe deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai ka ndërtuar një karrierë të gjatë akademike në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, ku ka ushtruar funksionin e profesorit dhe të dekanit për disa mandate. Gjatë karrierës së tij ka qenë autor i më shumë se njëqind punimeve dhe publikimeve shkencore, duke trajtuar tema që lidhen me historinë, studimet islame, dialogun ndërfetar, kulturën e paqes dhe bashkëjetesën ndërmjet komuniteteve.

Prezantimi - Toleranca Ndërfetare

Në kuadër të tryezës së rrumbullakët, Prof. Dr. Fahrush Rexhepi mbajti prezantimin me temën "Toleranca ndërfetare te shqiptarët", duke trajtuar një nga dimensionet më të rëndësishme të dialogut ndërkulturor në Kosovë.

Në fjalën e tij ai theksoi se historia e shqiptarëve është karakterizuar nga bashkëjetesa ndërfetare dhe respekti reciprok ndërmjet komuniteteve fetare, duke e konsideruar këtë traditë si një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë kosovare. Sipas tij, toleranca ndërfetare nuk duhet të shihet vetëm si trashëgimi historike, por si një vlerë që duhet të kultivohet vazhdimisht përmes arsimit dhe institucioneve publike.

Prof. Rexhepi argumentoi se universitetet luajnë një rol të pazëvendësueshëm në promovimin e kësaj kulture, pasi ato janë mjedise ku takohen studentë me përkatësi të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore. Në këtë kontekst, ai theksoi rëndësinë e zhvillimit të programeve akademike që promovojnë dialogun ndërfetar, edukimin qytetar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Ai u ndal edhe te rëndësia e mendimit kritik në luftimin e stereotipeve dhe paragjyimeve. Sipas tij, universitetet duhet të krijojnë një kulturë akademike ku dallimet trajtohen si pasuri shoqërore dhe jo si faktor ndarës. Vetëm përmes edukimit cilësor dhe komunikimit të hapur mund të ndërtohet besimi ndërmjet komuniteteve.



Toleranca ndërfetare si vlerë akademike

Lazar Radulović

Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lazar Radulović është deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe përfaqësues i komunitetit serb. Gjatë angazhimit të tij publik ai është fokusuar në promovimin e të drejtave të komuniteteve, dialogut ndëretnik dhe pjesëmarrjes së barabartë të komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike. Në veprimtarinë e tij parlamentare ai ka mbështetur iniciativa që synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe avancimin e politikave për integrim dhe barazi.

Prezantimi - Përvojat e Komuniteteve

Në prezantimin e tij me temën "Përvojat e komuniteteve", z. Radulović trajtoi mënyrën se si komunitetet e perceptojnë universitetin si institucion publik dhe si hapësirë për zhvillimin e dialogut dhe bashkëpunimit.

Ai theksoi se universitetet kanë potencial të madh për të ndërtuar ura komunikimi ndërmjet komuniteteve, mirëpo ky potencial duhet të shoqërohet me politika konkrete që garantojnë përfaqësim, përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të të gjitha komuniteteve në jetën akademike.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimit iu kushtua perceptimit të komuniteteve lidhur me nivelin e përfaqësimit të tyre në universitetet publike. Ai argumentoi se ndjenja e përkatësisë dhe përfshirjes është një element thelbësor për ndërtimin e besimit ndaj institucioneve të arsimit të lartë dhe se universitetet duhet të krijojnë mekanizma që sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë studentët.

Gjithashtu, ai vlerësoi rëndësinë e aktiviteteve të përbashkëta akademike, shkëmbimeve studentore dhe projekteve ndërkomunitare si instrumente që kontribuojnë në reduktimin e stereotipeve dhe krijimin e një kulture të dialogut dhe bashkëpunimit.



Përfaqësim dhe përfshirje në jetën akademike

Arlinda Muça

Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Arlinda Muça është juriste dhe anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjatë karrierës së saj profesionale është angazhuar në avancimin e sundimit të ligjit, pavarësisë së sistemit prokurorial dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përmes funksioneve institucionale ka kontribuar në zhvillimin e politikave që promovojnë barazinë para ligjit, luftimin e diskriminimit dhe forcimin e integritetit institucional.

Në prezantimin e saj, znj. Muça trajtoi temën "Diskriminimi dhe pengesat", duke analizuar diskriminimin nga perspektiva juridike dhe institucionale. Ajo theksoi se diskriminimi nuk paraqitet vetëm në forma të drejtpërdrejta, por shpesh manifestohet përmes praktikave të fshehta institucionale që ndikojnë në qasjen e barabartë në arsim, punësim dhe pjesëmarrje publike.

Sipas saj, institucionet publike dhe universitetet duhet të ndërtojnë mekanizma të qartë për identifikimin dhe adresimin e rasteve të diskriminimit, duke garantuar zbatim të plotë të legjislacionit për barazi dhe mosdiskriminim. Ajo nënvizoi se edukimi juridik dhe ngritja e vetëdijes për të drejtat e njeriut janë ndër mekanizmat më efektivë për parandalimin e diskriminimit.



11 Panelistët - Sistemi i Drejtësisë Agron Karatash

Agron Karatash

Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren

Agron Karatash është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren me përvojë shumëvjeçare në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Gjatë ushtrimit të funksionit të tij ka trajtuar çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave themelore, zbatimin e ligjit dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Në diskutimin e tij, gjyqtari Karatash trajtoi diskriminimin nga perspektiva gjyqësore, duke analizuar rëndësinë e mbrojtjes efektive të të drejtave të qytetarëve përmes sistemit të drejtësisë. Ai theksoi se gjykatat kanë rol kyç në garantimin e barazisë para ligjit dhe në ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.



Drejtësia dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Anita Çavdarbasha-Korenica

Zëvendëse e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës

Anita Çavdarbasha-Korenica është juriste me përvojë të gjatë në fushën e të drejtave të njeriut, legjisllacionit evropian dhe administratës publike. Studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare (LL.M.) në të Drejtën Evropiane i ka zhvilluar në Europa-Kolleg Hamburg në Gjermani. Para emërimit në pozitën e Zëvendësës së Avokatit të Popullit, ajo ka ushtruar funksione të rëndësishme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Që nga viti 2022 ushtron funksionin e Zëvendësës së Avokatit të Popullit, duke u angazhuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Prezantimi - Bashkëpunimi Ndëretnik

Në prezantimin e saj, znj. Çavdarbasha-Korenica trajtoi temën "Bashkëpunimi ndëretnik – Diskriminimi dhe pengesat", duke ofruar një analizë të rolit të institucioneve të pavarura në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe promovimin e barazisë.

Ajo theksoi se mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk kufizohet vetëm në trajtimin e ankesave individuale, por përfshin edhe krijimin e politikave parandaluese që promovojnë barazinë, përfshirjen dhe mosdiskriminimin në të gjitha institucionet publike, përfshirë universitetet.

Në vijim të diskutimit, ajo vlerësoi se universitetet kanë potencial të madh për të ndërtuar kulturën e respektimit të diversitetit përmes edukimit, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare. Ajo theksoi se promovimi i të drejtave të njeriut duhet të jetë pjesë integrale e kulturës universitare.

Gjithashtu, znj. Çavdarbasha-Korenica nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet universitetit, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera publike për zhvillimin e projekteve të përbashkëta që promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe luftimin e diskriminimit.



Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe përfshirje

Panelistët – Perfaqësues të komuniteteve

Mirzet Džogović

Mirzet Džogović

Zëvendëskryetar i Komunës së Pejës për Komunitete

Mirzet Džogović është Zëvendëskryetar i Komunës së Pejës për Komunitete dhe një nga përfaqësuesit institucionalë më aktivë të komunitetit boshnjak në Kosovë. Në ushtrimin e funksionit të tij ai është përgjegjës për koordinimin e politikave komunale që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale dhe komuniteteve jo-shumicë.

Prezantimi - bashkëpunimi Ndëretnik

Në prezantimin e tij, z. Džogović trajtoi çështjen e diskriminimit dhe barrierave që vazhdojnë të ndikojnë në jetën e komuniteteve jo-shumicë, duke u ndalur veçanërisht në sfidat që lidhen me qasjen në shërbime publike, arsim dhe pjesëmarrje institucionale.

Ai theksoi se diskriminimi nuk manifestohet gjithmonë në forma të drejtpërdrejta, por shpesh paraqitet përmes barrierave administrative, sociale dhe ekonomike që kufizojnë mundësitë e komuniteteve për pjesëmarrje të barabartë në jetën publike.

Duke u mbështetur në përvojën e tij në qeverisjen lokale, ai argumentoi se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve komunale dhe universiteteve mund të kontribuojë në identifikimin dhe adresimin e këtyre sfidave përmes projekteve të përbashkëta kërkimore, aktiviteteve edukative dhe iniciativave komunitare.

Në përfundim ai vlerësoi se universitetet duhet të jenë partnerë strategjikë të institucioneve lokale në promovimin e dialogut ndërkomunitar dhe në fuqizimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset demokratike.



Panelistët – Perfaqesues të komuniteteve Dr. Sc. Lendrit Qeli

Dr. Sc. Lendrit Qeli

Udhëheqës i Zyrës dhe Kryesues i Kolegjlumit të ZKKK/AKK

Dr. Sc. Lendrit Qeli është drejtues institucional me përvojë në administratën publike dhe në zhvillimin e politikave që lidhen me komunitetet, qeverisjen e mirë dhe të drejtat e njeriut. Gjatë karrierës së tij ka kontribuar në koordinimin e proceseve ndërinstitucionale që synojnë përmirësimin e pozitës së komuniteteve jo-shumicë dhe forcimin e mekanizmave institucionale për promovimin e barazisë dhe përfshirjes.

Prezantimi - Barrierat

Në prezantimin e tij, Dr. Qeli trajtoi barrierat sociale, ekonomike dhe kulturore që vazhdojnë të ndikojnë në pjesëmarrjen e komuniteteve në jetën akademike dhe institucionale.

Ai theksoi se përveç barrierave ligjore, ekzistojnë edhe pengesa të karakterit social dhe ekonomik që kufizojnë mundësitë e komuniteteve për të përfituar nga arsimi i lartë dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën publike.

Në analizën e tij ai argumentoi se universitetet duhet të bashkëpunojnë më ngushtë me institucionet shtetërore dhe pushtetin lokal për të identifikuar këto sfida dhe për të zhvilluar politika të bazuara në evidencë, të cilat kontribuojnë në eliminimin e pabarazive dhe promovimin e mundësive të barabarta.

Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e hulumtimeve shkencore dhe analizave empirike në hartimin e politikave publike, duke vlerësuar hulumtimin e realizuar nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut si një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim.



Vlora Latifi

Koordinatorë, Organizata "Syri i Vizionit"

Vlora Latifi është koordinatorë e organizatës "Syri i Vizionit", një organizatë e shoqërisë civile me veprimtari shumëvjeçare në promovimin e të drejtave të njeriut, përfshirjes sociale, fuqizimit të komuniteteve dhe zhvillimit të iniciativave që promovojnë dialogun dhe bashkëpunimin ndërkomunitar në Kosovë.

Përmes projekteve të shumta të realizuara në partneritet me institucione publike dhe organizata ndërkombëtare, ajo ka kontribuar në fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në ndërtimin e kohezionit social dhe

Prezantimi - rëndësinë e bashkëpunimit ndëretnik nga perspektiva e shoqërisë civile

Në prezantimin e saj, znj. Latifi trajtoi rëndësinë e bashkëpunimit ndëretnik nga perspektiva e shoqërisë civile. Ajo theksoi se organizatat e shoqërisë civile luajnë rol plotësues ndaj institucioneve publike dhe universiteteve në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve.

Ajo argumentoi se projektet që bashkojnë të rinjtë nga komunitete të ndryshme krijojnë mundësi reale për tejkalimin e stereotipeve dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme të bashkëpunimit.



Tryeza e rumbullakët dëshmoi se universitetet përfaqësojnë institucione me potencial të konsiderueshëm për promovimin e dialogut ndërkulturor dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërmjet komuniteteve në Kosovë.

Gjetjet Kryesore

- ✓ Arsimi i lartë duhet të fokusohet në zhvillimin profesional dhe formimin qytetar
- ✓ Promovimi i diversitetit kulturor kërkon politika të mirëfillta institucionale
- ✓ Universiteti "Haxhi Zeka" është shembull pozitiv në promovimin e dialogut
- ✓ Bashkëpunimi ndërinstitucional është thelbësor për suksesin e iniciativave
- ✓ Programet shumëgjuhëshe garantojnë qasje të barabartë në arsim
- ✓ Diskriminimi duhet të adresohet përmes mekanizmave institucionale

Rezultatet e hulumtimit të prezantuar gjatë aktivitetit, së bashku me diskutimet e zhvilluara nga panelistët dhe pjesëmarrësit, ofrojnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e politikave të ardhshme universitare dhe për iniciimin e projekteve të reja që promovojnë dialogun ndërkulturor dhe bashkëjetesën në Kosovë.



Bazë për zhvillimin e politikave të ardhshme

14 Rekomandimet

Në përfundim të aktivitetit u formulua një sërë rekomandimesh që synojnë avancimin e rolit të universiteteve në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe diversitetit kulturor:

1. Të integrohen në mënyrë më të strukturuar parimet e diversitetit kulturor, përfshirjes dhe dialogut ndërkomunitar në strategjitë zhvillimore të universiteteve.

2. Të forcohen politikat institucionale për barazi, mosdiskriminim dhe pjesëmarrje aktive të komuniteteve në jetën akademike.

3. Të mbështetet zhvillimi dhe avancimi i programeve studimore në gjuhët e komuniteteve, si mekanizëm për garantimin e qasjes së barabartë në arsimin e lartë.

4. Të organizohen rregullisht forume akademike, tryeza të rumbullakëta, konferenca shkencore dhe aktivitete studentore që promovojnë dialogun ndërkulturor.

5. Të zhvillohen projekte të përbashkëta kërkimore ndërmjet universiteteve, institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, me fokus në diversitetin kulturor dhe kohezionin social.

6. Të fuqizohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët zhvillimorë për zbatimin e iniciativave që kontribuojnë në promovimin e paqes dhe të drejtave të njeriut.



Rekomandime për zhvillimin e ardhshëm institucional

Në përmblyllje të tryezës së rrumbullakët u bë një përmbledhje e diskutimeve dhe e mesazheve kryesore të prezantuara gjatë aktivitetit. Organizatorët vlerësuan nivelin e lartë të pjesëmarrjes dhe cilësinë e diskutimeve, duke theksuar se objektivat e aktivitetit u realizuan me sukses.

U theksua se dialogu ndërkulturor dhe promovimi i diversitetit kulturor nuk duhet të kufizohen vetëm në aktivitete simbolike, por duhet të jenë pjesë e vazhdueshme e politikave dhe praktikave institucionale të universiteteve dhe institucioneve publike.

Në këtë kuadër, Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut shprehu gatishmërinë për të vazhduar organizimin e aktiviteteve të ngjashme, duke fuqizuar bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, me qëllim promovimin e paqes, dialogut dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Pas përfundimit të pjesës zyrtare të aktivitetit, pjesëmarrësit vazhduan komunikimin në një drekë të përbashkët, e cila shërbeu si mundësi shtesë për rrjetëzim profesional dhe shkëmbim përvojash ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse.

Tryeza e Rrumbullakët "Universiteti si platformë për dialog ndërkulturor dhe bashkëjetesë në Kosovë" përfaqëson një hap të rëndësishëm në afirmimin e rolit të arsimit të lartë në ndërtimin e paqes, dialogut dhe respektimit të diversitetit kulturor në Kosovë.

